

Sami Ahmeti
Kryesues i Kuvendit Komunal
Komuna e Obiliq

I nderuar Kryesues Z. Ahmetii

Siç ju kemi njoftuar paraprakisht, Konsorciumi i përbërë nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI), Instituti GAP, ATRC dhe CBM ka nisur procesin e monitorimit të performancës së anëtarëve të kuvendeve komunale. Në kuadër të këtij procesi, planifikojmë të organizojmë një sesion të shkurtër informues për anëtarët e Kuvendit Komunal.

Për këtë qëllim, ju lutemi të na mundësoni rreth 5 minuta në fillim të seancës për të prezantuar shkurtimisht qëllimin e monitorimit dhe metodologjinë që do të zbatohet gjatë këtij procesi.

Njëkohësisht, do t'ju ishëm mirënjohës nëse mund të na informoni për datën dhe orarin e seancës së ardhshme të Kuvendit Komunal, në mënyrë që të koordinojmë pjesëmarrjen tonë.

Nëse gjatë muajit gusht planifikohet mbajtja e ndonjë seance, do ta vlerësonim mundësinë që sesioni informues të realizohet para fillimit të mbledhjes. Në të kundërt, sesioni mund të mbahet gjatë seancës së muajit shtator.

Gjithashtu, do të ndajmë me anëtarët e Kuvendit Komunal një broshurë informuese, e cila ofron detaje mbi indikatorët, metodologjinë e vlerësimit dhe sistemin e pikëzimit.

Ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj.

Me respekt,

Arbnor Mjeku
ATRC